



---

**VENDIM**  
**Nr.99 Datë 07.12.2010**

**PËR**  
**PËRCAKTIMIN E TARIFËS TË SHPËRNDARJES SË ENERGJISË**  
**ELEKTRIKE NGA CEZ SHPËRNDARJA SH.A PËR PERIUDHEN 1**  
**JANAR – 31 DHJETOR 2011**

Në mbështetje të neneve 8, pika 2, germa “b” 9, 26 pika 1, 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 15, 20 dhe 21 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s Nr.21, datë 18.03.2009, Vendimit nr.79, datë 26.06.2008, “Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës së shpërndarjes së energjisë elektrike”, Vendimin Nr.65, date 13.09.2010 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s “Për fillimin e procedurave për përcaktimin e tarifës të shpërndarjes së energjisë elektrike nga Cez Shpërndarja sh.a për vitin 2011”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 07.12.2010, pasi shqyrtoi aplikimin e Cez Shpërndarja sh.a për përcaktimin e tarifës të shpërndarjes së energjisë elektrike për vitin 2011, si dhe relacionin e Grupit të Punës të ERE-s,

**Vendosi :**

1. Tarifa e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike për Cez Shpërndarja sh.a për periudhen 1 Janar – 31 Dhjetor 2011 do të jete **6,30 leke/kWh**.
2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e Cez Shpërndarja sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.  
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.